

Daut

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VLORË
DREJTORIA E INFRASTRUKTURËS DHE INVESTIMEVE PUBLIKE

Nr. 14363 prot.,

Vlorë, më 17 . 09 .2024

PROJEKTVENDIM

Nr. _____ datë _____ 2024

PËR MIRATIMIN E LISTËS SË FAMILJEVE DHE INDIVIDËVE, QË PËRFITOJNË SUBVENCIONIN E QIRASË NË TREG TË LIRË DHE VLERAT E SUBVENCIONIT TË QIRASË PËR ÇDO RAST.

Këshilli i Bashkisë Vlorë, në mbështetje të ligjit nr.139/2015 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” neni 8 pika 1 dhe 2, neni 9 pika 1.1/b. neni 24 pika 1.2, të ligjit nr.22/2018 datë 03.05.2018 “Për strehimin social” të ndryshuar, neni 2 pika 34/a,b,c, pika 35, pika 36, pika 42, neni 33, neni 38, të VKM Nr.362 datë 29.05.2019 “Për kriteret e dhënies së subvencionit të qirasë për kategoritë që gëzojnë përparësi në subvencionin e qirasë në tregun e lirë, nëpërmjet buxhetit të shtetit dhe mënyrën e llogaritjes së tij”, të VKM Nr 459 datë 3.7.2019 “Për rregullat për administrimin e kërkesave të njësive të vetëqeverisjes vendore për fonde nga buxheti i shtetit për subvencionimin e qirasë dhe uzufuktit, mënyrën e financimit të subvencionit, monitorimin dhe bashkëpunimin ndërmjet njësive të vetëqeverisjes vendore dhe ministrisë përgjegjëse për strehimin”, të VKM Nr.384 datë 12/06/2019 “Për përcaktimin e dokumentacionit për të përfutuar strehim sipas çdo programi social të strehimit dhe të afateve e të procedurave të miratimit nga organet e vetëqeverisjes vendore”, të VKM Nr.301, datë 15.04.2020 “Për normat e strehimit, si edhe kushtet e standartet për banesat sociale me qira që blihen në treg dhe banesat me kosto të ulët”, pasi mori në shqyrtim materialin e paraqitur nga Drejtoria e infrastrukturës dhe Investimeve Publike dhe Vendimin Komisionit të Strehimit të Bashkisë Vlorë;

V E N D O S I

- I. Të miratojë listën e familjeve dhe individëve, që përfitojnë subvencionin e qirasë në treg të lirë dhe vlerat e subvencionit të qirasë për çdo rast, tabela bashkëlidhur.
- II. Efektet financiare sipas pikës 1 do të mbulohen nga buxheti i Bashkisë Vlorë për vitin 2024 e në vazhdim.
- III. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Infrastrukturës dhe Investimeve Publike, si edhe Drejtoria e Financës pranë Bashkisë Vlorë
- IV. Ky vendim hyn në fuqi sipas ligjit nr.139/2015 date 17.12.2015, neni 59 pika 6

Miratoi: *D.Demiri*
Miratoi: *Z.Selmani*



KRYETAR


Ermal Dredha

LISTA E FAMILJEVE / INDIVIDIVE QE PËRFITOJNE SUBVENCIONIN E QIRASE PËR VITIN 2024

(Grupi I katërt)

Nr.	Emri	Atësia	Mbiemri	Kategoria sipas nënit 16 të ligjit nr.22/2018	Përberja familjare	Struktura e ap. sipas normave të strehtimit	Sipërfaqja e ap. 2 sipas kontra- tes qirase	Qiraja mes e apart. në treg për strukturën të lakon	Të ardhurat familjare mujore	Kategoria sipas pikës 45 të nënit 2 të ligjit 22/2018	Atësia përball. e familjes	Qiraja e përball. përball.	Sub- vencioni mujor	Subvencioni vjetor 2024
1	Lirza	Buran	Çuni	status verberie	1	garsonierë	34,83	10000	0	0	0%	0	10000	120000
2	Hektor	Vasil	Vangjeli	2PAK	3	1+1	64,1	15000	0	0	0%	0	15000	180000
3	Taze	Izet	Mataj	të moshuar, 1 sëm. kron	2	1+1	63	15000	18193	Ash. ulëta	15%	2729	12271	147252
4	Marsela	Lavdesh	Caushtaj	f. njëpr. Grua e dhun.	4	2+1	69	20000	41819	A. ulëta	15%	6273	13727	164724
5	Dallandyshe	Rustem	Mataj	Kom. egi. E moshuar	1	garsonierë	61	10000	9327	Ash. ulëta	15%	1399	8601	103212
6	Andrea	Selim	Thomaj	2 të moshuar	2	1+1	105,40	10000	26804	Ash. ulëta	15%	4020	5980	71760
Σ													65579	786948





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VLORË
DREJTORIA E INFRASTRUKTURËS DHE INVESTIMEVE PUBLIKE

RELACION

Për projekt-vendimin

PËR MIRATIMIN E LISTËS SË FAMILJEVE DHE INDIVIDËVE, QË PËRFITOJNË SUBVENCIONIN E QIRASË NË TREG TË LIRË DHE VLERAT E SUBVENCIONIT TË QIRASË PËR ÇDO RAST.

Gjatë vitit 2024 janë paraqitur pranë Bashkisë Vlorë kërkesa të familjeve në nevojë për strehim, që banojnë me qira në treg të lirë, për të përfitur nga projekti i subvencionimit të qirasë. Sipas periudhës në të cilën familjet kanë paraqitur aplikimin, nga strukturat përkatëse të bashkisë janë kryer procedurat e vlerësimit dhe të miratimit në Këshillin e Bashkisë të këtyre familjeve.

1. Me Vendim të Këshillit të Bashkisë Vlorë Nr. 12, datë 26.02.2024 është miratuar lista e familjeve dhe individëve që përfitojnë subvencionin e qirasë në treg të lirë për vitin 2024, grupi i parë i përfituesëve me 16 emra, me fondin total = 1787664 lekë

2. Me Vendim të Këshillit të Bashkisë Vlorë Nr. 36, datë 30.04.2024 është miratuar lista e familjeve dhe individëve që përfitojnë subvencionin e qirasë në treg të lirë për vitin 2024, grupi i dytë i përfituesëve me 7 emra, me fondin total= 894 252 lekë

3. Me Vendim të Këshillit të Bashkisë Vlorë Nr. 59, datë 27.06.2024 është miratuar lista e familjeve dhe individëve që përfitojnë subvencionin e qirasë në treg të lirë për vitin 2024, grupi i tretë i përfituesëve me 2 emra, me fondin total= 343212 lekë

Aktualisht rezultojnë përfitues të subvencionit të qirasë në treg të lirë nga buxhti i Bashkisë Vlorë për vitin 2024, 25 familje/individë me shumën totale = 3 025 128 lekë.

Me këtë projektvendim vijnë për tu miratuar nga Këshilli Bashkisë Vlorë 6 familje dhe individë të kategorive si më poshtë,

- Të moshuar të vetmuar, 3 raste
- Me status invalidi, 2 raste
- Familje njëprindërore, grua e dhunuar, 1 rast
- Anëtare e komunitetit egjiptian, 1 rast.

Shuma totale vjetore e subvencionit të qirasë për këto familje/individë është 786 948 lekë.

Në zbatim të ligjit nr.22/2018, datë 03.05.2018 “Për strehimin social” të ndryshuar, të VKM Nr.362, datë 29.05.2019 “Për kriteret e dhënies së subvencionit të qirasë për kategoritë që gëzojnë përparësi në subvencionimin e qirasë në tregun e lirë, nëpërmjet buxhetit të shtetit, dhe mënyrën e llogaritjes së tij”, të VKM Nr.459 datë 3.7.2019 “Për rregullat për administrimin e kërkesave të njësive të vetëqeverisjes vendore për fonde nga buxheti i shtetit për subvencionimin e qirasë dhe uzufuktit, mënyrën e financimit të subvencionit, monitorimin dhe bashkëpunimin ndërmjet njësive të vetëqeverisjes vendore dhe ministrisë përgjegjëse për strehimin”, të VKM Nr.384 datë 12/06/2019 “Për përcaktimin e dokumentacionit për të përfitur strehim sipas çdo programi social të strehimit dhe të afateve e të procedurave të miratimit nga organet e vetëqeverisjes vendore” nga familjet është paraqitur dokumentacioni përkatës, ndërsa nga strukturat e bashkisë janë kryer procedurat përkatëse.

Komisioni i Strehimit të Bashkisë Vlorë i mbledhur në datën 12.09.2024 vlerësoi të gjitha kërkesat dhe dokumentacionin e paraqitur nga qytetarët. Për familjet me dokumentacionin e plotë të paraqitur dhe të verifikuara në terren për kushtet e banimit në përputhje me kontratat e qirasë, komisioni miratoi dhënien e subvencionit të qirasë, duke përcaktuar vlerën përfituese të subvencionit për çdo rast. Lista emërore e familjeve/individëve dhe të dhënat e detajuara për kushtet e strehimit, sociale, ekonomike, familjare, të dhënat sipas kontratës së qirasë, qiranë e përballeshme, subvencionin mujor dhe vjetor, janë pasqyruar në tabelën bashkëlidhur projektvendimit.

Sa më lart i kërkojmë Këshillit të Bashkisë të miratojë projektvendimin e paraqitur, me qëllim mbështetjen e familjeve në nevojë me vlerat përkatëse të subvencionit të qirasë.

Konceptoi: *D. Mustafaj*
Miratoi: *Z. Selmani*



KRYETAR
Ermal Dredha





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VLORË
KOMISIONI I STREHIMIT

Nr. 14363/1 prot..

Vlorë, më 17.09 .2024

MIRATOHET
KRYETAR

Ermal Dredha

VENDIM

Nr. 4, datë 12.09.2024

Mbi miratimin e familjeve/individëve që kanë aplikuar për të përfituar subvencion qiraje nga buxheti i Bashkisë Vlorë për vitin 2024, grupi i katërt.

Në zbatim të ligjit nr. 22/2018 datë 03.05.2018 "Për strehimin social" të ndryshuar, neni 2 pika 34/a,b,c, pika 35, pika 36, pika 42, neni 33, neni 38, të VKM Nr.362 datë 29.05.2019 "Për kriteret e dhënies së subvencionit të qirasë për kategoritë që gëzojnë përparësi në subvencionin e qirasë në tregun e lirë nëpërmjet buxhetit të shtetit dhe mënyrën e llogaritjes së tij", të VKM Nr.459 datë 3.7.2019 "Për rregullat për administrimin e kërkesave të njësisive të vetëqeverisjes vendore për fonde nga buxheti i shtetit për subvencionimin e qirasë dhe uzufruktit, mënyrën e financimit të subvencionit, monitorimin dhe bashkëpunimin ndërmjet njësisive të vetëqeverisjes vendore dhe ministrisë përgjegjëse për strehimin", Komisioni i Strehimit të Bashkisë Vlorë, i mbledhur sot në datën 12.09.2024, pasi mori në shqyrtim kërkesat e qytetarëve bashkë me dokumentacionin përkatës për të përfituar nga projekti i subvencionimit të qirasë në tregun e lirë për vitin 2024;

KONSTATOI SE

Deri në datën e sotme 12.09.2024 kanë paraqitur kërkesat 6 familje dhe individë të pastrehë, që banojnë me qira në tregun e lirë dhe nuk kanë mundësi ekonomike për të përballuar vetë gjithë vlerën e qirasë. Bashkë me pamundësinë ekonomike këto familje paraqesin një sërë problematikash familjare dhe sociale si;

- Të moshuar të vetmuar, 3 raste
- Me status invalidi, 2 raste
- Familje njëprindërore, grua e dhunuar, 1 rast
- Anëtare e komunitetit egjiptian, 1 rast.

Sa më lart komisioni

VENDOSI



1. Të përcaktojë të ardhurat mujore të të gjithë aplikantëve në momentin e aplikimit pranë Bashkisë Vlorë dhe të kategorizojë këto të ardhura sipas pikës 45, të nenit 2, të ligjit 22/2018 të ndryshuar, si më poshtë:

- 1.1 Luiza Buran Çuni, të ardhura 0, aftësia përballuese=0, qiraja e përballueshme =0.
- 1.2 Hektor Vasil Vangjeli, të ardhura 0, aftësia përballuese=,0 qiraja e përballueshme =0.
- 1.3 Taze Izet Mataj, të ardhurat mujore nga dy pensione=18193, A=shumë të ulëta, aftësia përballuese =15%, qiraja e përballueshme =2729 lekë në muaj.
- 1.4 Marsela Lavdosh Caushaj, të ardhurat mujore=41819 lekë, A=sh.ulëta, aftësia përballuese =15%, qiraja e përballueshme Qp=6273 lekë
- 1.5 Dallandyshe Rustem Mataj, të ardhurat mujore=9327 lekë, A=shumë të ulëta, aftësia përballuese =15%, qiraja e përballueshme =1399 lekë në muaj
- 1.6 Andrea Selim Thomai, të ardhurat mujore nga dy pensionet =26804 lekë, A=shumë të ulëta, qiraja e përballueshme =15%

2. Të përcaktojë masën e subvencionit të qirasë që përfiton çdo aplikant, në muaj dhe vit.

- 2.1 Luiza Buran Çuni, S mujor=10000, Svjetor= 120000 lekë
- 2.2 Hektor Vasil Vangjeli, S mujor= 15000, Svjetor = 180000 lekë
- 2.3 Taze Izet Mataj, S mujor= 12271 lekë, Svjetor= 147252 lekë
- 2.4 Marsela Lavdosh Caushaj, Sm=13727, Sv=164724 lekë
- 2.5 Dallandyshe Rustem Mataj, Sm=8601, Sv=103212 lekë
- 2.6 Andrea Selim Thomai, Sm= 5980 lekë, Sv=71760 lekë

3. Të miratojë dhënien e subvencionit të qirasë dhe vlerat përkatëse për familjet sipas tabelës së mëposhtme, që do të mbulohen nga buxheti i Bashkisë Vlorë për vitin 2024.

Nr	Emër /Aftësia/ Mbiemër	Të ardhurat mujore (lekë)	Qiraja mesatare në treg të lirë	Subvencionit lekë/muaj	Subvencionit vjetor lekë/vit
1.	Luiza Buran Çuni	0	10000	10000	120000
2.	Hektor Vasil Vangjeli	0	15000	15000	180000
3.	Taze Izet Mataj	18193	15000	12271	147252
4.	Marsela Lavdosh Caushaj	41819	20000	13727	164724
5.	Dallandyshe Rustem Mataj	9327	10000	8601	103212
6.	Andrea Selim Thomai	26804	10000	5980	71760

4. Me përfundimet e mësipërme të përgatitet projektvendimi që do të paraqitet për miratim në Këshillin e Bashkisë.

KOMISIONI

- 1. Irena Toshkallari
- 2. Zambak Selmani
- 3. Dorian Demiri
- 4. Skerdilajd Hunda
- 5. Orest Ruçaj
- 6. Manuela Prifti
- 7. Donald Leskaj

- 8. Bledar Toja
- 9. Kanan Shakaj
- 10. Genard Fegaj
- 11. Selim Haskoçelaj
- 12. Birçe Aliraj
- 13. Drita Mustafai